



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 6 , datë 19/05/2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”,
SHOQËRISË “ALESIO 2014” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, shoqërisë “Alesio 2014” sh.p.k., me vendndodhje, në lumin Fan i Madh, degë e lumit Mat HEC “Fushë Arrëz”, në Bashkinë Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, sipas këtyre koordinatave:

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC “Fushë Arrëz”

Vepra e marrjes nr. 1:

- X= 503401.71
- Y= 4660061.28
- Z=549.3 m.m.n.d

Godina e Centralit:

- X= 500700.34
- Y= 4658020.41
- Z=486 m.m.n.d
- Qmes=2.64 m³/s
- Qllog=4.42 m³/s
- Qeko=0.221 m³/s
- Fuqia e instaluar N= 1,990 kW
- Energjia Vjetore E=6,147,116 kWh/vit.

2. Zbatimi i lejes për përdorim burimi ujqor nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujtitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI


